



# MANDATI DHE IMUNITETI I DEPUTETËVE

## MANDATI I DEPUTETËVE

Mandati paraqet të drejtën e deputetit t'i përfaqësojë qytetarët dhe gjatë kryerjes së detyrës së deputetit të vendosë sipas bindjes së tij (mandati i lirë).

Deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjidhen për katër vjet në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Deputetët zgjidhen çdo katër vjet në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër parlamentare, ose në afat prej 60 ditësh, nga dita e shpërbërjes së Kuvendit.

Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi dhe ai zgjat nga dita e verifikimit deri në ditën e verifikimit të mandatit të deputetëve të sapozgjedhur, por jo më tepër se 4 vjet.

Mandati i deputetëve mund të vazhdohet vetëm gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Mandati i deputetëve në Kuvendi verifikohet në mbledhjen konstituive me propozim të Komisionit Verifikues të Kuvendit.

Mbledhja konstituive e Kuvendit mbahet më së voni 20 ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve. Nëse mbledhja konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, atëherë deputetët mbledhen vetë dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e 21 pas mbajtjes së zgjedhjeve.

**Me verifikimin e mandatit deputeti merr të drejta dhe detyrime të përcaktuara me Kushtetutë, ligj, Rregulloren e Punës së Kuvendit, dispozita të tjera dhe akte të përgjithshme.**

Deputetit nuk mund t'i hiqet funksioni, mirëpo mund t'i ndërpritet ose t'i merret mandati para se të përfundojë periodha për të cilën është zgjedhur.

Deputetit i ndërpritet mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur: nëse jep dorëheqje; nëse është gjykuar për vepër penale për të cilën parashihet dënim me burg me kohëzgjatje prej së paku pesë vite; nëse ka mospërputhje me funksionin e deputetit; nëse i hiqet shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut; nëse me vendim të plotfuqishëm privohet nga aftësia për të vepruar ose në rast të vdekjes.

Deputetit mund t'i merret mandati, nëse është i gjykuar për vepër penale ose për vepër tjetër ndëshkuese, që e bën të padenjë për kryerjen e funksionit të deputetit, si dhe për mungesë të paarsyeshme nga Kuvendi për më shumë se gjashtë muaj.

Propozim për heqje të mandatit parashtron Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit, në bazë të njoftimit të Kryetarit të Kuvendit. Nëse deputeti është i gjykuar, njoftimin për Kryetarin e Kuvendit e dorëzon gjykata që e ka shqiptuar dënimin. Propozimi i komisionit shqyrtohet në seancën e parë të radhës të Kuvendit, kështu që shqyrtimi mund të mbarojë me marrjen e vendimit për heqje të mandatit të deputetit. Vendimi merret me shumicën e dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Mandati i deputetëve mund të përfundojë para kohe edhe në rast të vetëshpërbërjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi shpërbëhet, nëse për një gjë të tillë voton shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

- Deputetët zgjidhen për katër vjet.
- Deputetit i ndërpritet mandati ose mund t'i merret mandati vetëm në raste dhe mënyra të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

## IMUNITETI I DEPUTETËVE

Deputetët në Republikën e Maqedonisë gëzojnë imunitet nga dita e verifikimit të mandatit e deri në përfundim të tij.

Sipas Kushtetutës, deputetët gëzojnë dy lloje të imunitetit: papërgjegjshmërinë e deputetit (imuniteti material ose thelbësor) dhe paprekshmërinë e deputeti (imuniteti procedural). Bashkarisht, këto dy lloje të imuniteteve deputetit i sigurojnë lirinë në kryerjen e funksionit të deputetit dhe pavarësinë e trupit parlamentar në kryerjen e pushtetit ligjvënës.

Papërgjegjësia e deputetit nënkupton pamundësinë që ai të thirret në përgjegjësi penale ose përgjegjësi tjetër, ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në seancat e Kuvendit ose në trupat e tij të punës. Në këtë mënyrë imuniteti material e garanton lirinë e fjalës, por nuk e mbron deputetin nga përgjegjësia për mendimin e thënë jashtë seancave të Kuvendit ose të trupave të tij punues.

Kështu për shembull deputeti nuk do të përgjigjet nëse ofendon ndonjë deputet ose qytetarë gjatë debateve parlamentare, por do të përgjigjet për ofendimin që e ka bërë jashtë Kuvendit.

Ky lloj i imunitetit nuk mund të jetë lëndë diskutimi për heqje të imunitetit dhe vlen edhe pas përfundimit të mandatit të deputetit.

Imuniteti material nuk e përjashton as detyrën e deputetit për ta respektuar Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ka të drejtë ta largojë deputetin nga seanca, nëse edhe përkundër vërejtjes ose heqjes së të drejtës për fjalë, ai edhe më tej e shkel rendin e seancës ose përdor shprehje me të cilat shkelet dinjiteti i Kuvendit.

Paprekshmëria e deputetit (imuniteti procedural) ka të bëjë me veprat penale, të kryera jashtë trupit përfaqësues. Ky lloj imuniteti nuk do të thotë se kundër deputetit nuk mund të iniciohet procedurë për përcaktim të përgjegjësive penale, ose se deputeti nuk mund të gjykohet për vepër penale.

Imuniteti procedural nënkupton pamundësi, që deputeti të paraburgoset pa miratimin e Kuvendit, vetëm nëse është zënë në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale, për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej minimum pesë vjet.

Në rastin e parë, organi kompetent i dorëzon kërkesë Kryetarit të Kuvendit për miratim të paraburgimit të deputetit. Në rastin e dytë, organi kompetent e njofton Kryetarin e Kuvendit se deputeti është paraburgosur, për shkak se është zënë në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale, për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej minimum pesë vjet. Organi kompetent e informon Kryetarin e Kuvendit për paraburgimin e deputetit, madje edhe kur ai nuk është thirrur në imunitetin e tij.

Kryetari i Kuvendit kërkesën për miratim të paraburgimit, gjegjësisht njoftimin se deputeti është paraburgosur, menjëherë ia dorëzon Komisionit për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit, i cili e ka për detyrë ta shqyrtojë kërkesën, përkatësisht njoftimin dhe në afat prej dy ditësh të dorëzojë raport te Kryetari i Kuvendit. Për mbledhjen e komisionit informohet edhe deputeti, të cilit i drejtohet kërkesa. Në bazë të raportit të komisionit, Kuvendi më së voni në afat prej tri ditësh vendos nëse do ta miratojë paraburgimin e deputetit.

Nëse Kuvendi nuk e miraton paraburgimin, atëherë deputeti do të lirohet menjëherë, madje edhe nëse deputeti nuk është thirrur në imunitetin e tij.

- Deputetët në Republikën e Maqedonisë gëzojnë dy lloje të imuniteteve: papërgjegjësia e deputetit (imuniteti material ose thelbësor) dhe paprekshmërinë e deputetit (imuniteti procedural)
- Imuniteti material e garanton lirinë e fjalës në seanca të Kuvendit ose në trupat e tij të punës
- Imuniteti procedural ka të bëjë me pamundësinë për paraburgim për vepra penale të kryera jashtë Kuvendit
- Imuniteti material vlen edhe pas ndërprerjes së mandatit të deputetit, ndërsa imuniteti procedural vlen vetëm derisa zgjat mandati i deputetit



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHËTJETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përgatitur nga Instituti Parlamentar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për menaxhimin e ndryshimeve (CMP). Përmajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SDC.